

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Driton Muharremi e Have Haliti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale të akuzuarit H.M. nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Përvetësimi në detyrë në vazhdim nga neni 425 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Mitrovicë, P.nr.60/2017 datë 10.05.2017 në seancën e kolegjit të mbajtur me 07.07.2017 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ashtu që aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Mitrovicë, P.nr.60/2017 datë 10.05.2017, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë-departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin P.nr.60/2017 datë 10.05.2017, e ka shpallur fajtor të akuzuarin H.M., për veprën penale Përvetësimi në detyrën neni 425 par.1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, për çka e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, të natyrës së njëjte apo natyrës me të rënd, brenda periudhës kohore prej 1 (një) vjet e 6 (gjashtë) muaj nga koha e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Obligohet i pandehuri të kompensoj shpenzimet e procedurës penale, paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, dhe shpenzimet tjera në shumën prej 20 euro, të gjitha brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Obligohet i pandehuri H.M. që të dëmtuarës kompanisë SHPK “X” në Vushtri me pronar XH.K. t’ia paguaj kompensoje dëmin e pësuar dhe atë 10% nga shuma totale e dëmit prej 4,950.03 Euro.Këtë shumë të dëmit obligohet tia paguaj në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur:

- Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën ashtu që ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë dhe ti shqiptojë një dënim me të ashpër.

- Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/I.nr.294/2017 të dt. 20.06.2017 ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë të aprovohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa është e pa bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt, konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit. As gjendja faktike nuk qe objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase nuk është kontestuar me ankesë, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në frymë të pretendimeve ankimore.

Duke vlerësuar çështjen përkritazi me pretendimet ankimore të prokurorisë lidhur me vendimin për dënim kjo gjykatë konsideron se ankesa e Prokurorisë e që ka të bëjë me lartësinë e dënimit është e pa bazuar. Prokuroria në ankesën e saj nuk thekson rrethana të cilat nuk janë vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë apo të cilat e njëjta nuk i ka pas të njohura por vetëm thekson se rrethanat lehtësuese janë mbivlerësuar dhe se është dashur të merret si rrethanë rënduese shkalla e përgjegjësisë penale, intensiteti i rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, dobia pasurore që i ka sjell vetes duke përvetësua parat që janë vlerësuar në bazë të detyrës dhe pozitës si agjent tregtar në shumë prej 4950,03 euro. Kjo gjykatë vlerëson se duke pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat drejtë i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë siç janë pranimi i fajësisë, fakti se i akuzuari është mbajtës i familjes, shprehja e keqardhjes dhe falja publike në seancë të dëmtuarit, pendimi dhe premtimi se në të ardhmen nuk do të përsëris veprimet e njëjta, sjellja korrekte, më parë i pa gjykuar dhe ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, dënimi i shqiptuar është në harmoni të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.300/17, më 07.07.2017

Procesmbajtësi,

Kryetarja e kolegjit- gjyqtarja

Bujar Balaj

1. Mejreme Memaj_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi_____

3. Have Haliti _____